

NJOFTIM
Nr. 159, datë 13.5.2020

**PËR VENDOSJEN E AFATIT PËRFUNDIMTAR TË PRANIMIT TË APLIKIMEVE
PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR AUTORIZIMIN E
ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE
PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI**

Duke marrë në konsideratë rifillimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, bazuar në vendimin nr. 143, datë 22.4.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”, si dhe duke patur parasysh që referuar vendimit nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, një pjesë e dokumentacionit të kërkuar duhet të sigurohet nga OJF-të nëpërmjet gjykatës, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton afatin përfundimtar për pranimin e aplikimeve për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore deri më datë 20.6.2020.

NJOFTIM

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR AUTORIZIMIN E
ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE
PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI**

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM-së nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, bën publik njoftimin si më poshtë:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse, që janë të interesuara të aplikojnë për të marrë autorizim nga ministri i Drejtësisë për të ofruar ndihmën juridike parësore, duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Procedura dhe dërgimi i dokumentacionit:

Dokumentacioni që duhet të depozitojnë organizatat jofitimprurëse (OJF), për aplikim, për marrjen e autorizimit që lëshohet nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:

- a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
- b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë së ofrimit të ndihmës juridike;
- c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vite të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:
 - i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) viteve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;
 - ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare;
 - iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte;
 - iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;
- ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- dh) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;

e) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.

f) adresën elektronike të komunikimit.

Aplikimi për autorizim, i shoqëruar me dokumentacionin e sipërpërmendur, dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në adresën: bulevardi “Zogu i Parë”, pranë Ministrisë së Drejtësisë, **deri më datë 20.6.2020.**

Aplikimet e paraqitura jashtë afatit nuk kualifikohen.